

Kukulla që dëgjon



Save the Children

Kukulla që dëgjon

Mëson të fshehtën e pemëve



Riprintimi i kësaj broshure u mundësua nga Save the Children, zyra në Shqipëri. Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne punojmë në 120 vende të botës. Ne mbrojmë jetën e fëmijëve; luftojmë për të drejtat e tyre dhe i ndihmojmë ata të përmbushin potencialin e tyre.

TIRANË, 2015

Kjo broshurë u riprintua në kuadër të projektit "Promovimi i të Drejtave të Fëmijëve për Arsim dhe Zhvillim" që zbatohet nga Save the Children në Shqipëri

ISBN : 978-1-920094-67-6

Copyright © 2008 Merle Levin

@Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e të dy organizatave si burim.

Drejtues të projektit:	Merle Levin and Turid Heiberg
Konceptuar dhe shkruar nga:	Merle Levin
Faqosje, dizajn dhe shtyp:	New Voices Publishing
Imazhet:	Jane Appleby
Riparë nga:	Allen Kalpin MD, Marit Eikaas Haavimb and Logan Lewis-Proudlock

Financuar nga:	Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme, Save the Children Norvegji, Save the Children Suedi
----------------	--


Botuar nga
Save the Children Suedi
Zyra rajonale për Azinë jugore dhe qendrore



Save the Children

Na ishte njëherë një kukull, të cilës më shumë se çdo gjë tjetër i pëlqente të dëgjonte histori që tregonin të tjerët. Të gjithë e quanin **Kukulla që Dëgjon**. Fëmijët e donin pa masë dhe përpiqeshin, kush e kush më shumë, t'i rrëfenin historitë e tyre, pasi ajo kishte një mënyrë të veçantë për t'i dëgjuar. Madje, ajo kishte edhe një **pallto-historish** e cila ishte magjike. Kur fëmijët i rrëfenin asaj një histori, mbi **pallton- e historive** shfaqeshin vizatime, njësoj si vizatimet në libra.

Nëse fëmijët i rrëfenin asaj një histori me një pemë, - mbi pallto shfaqej menjëherë një pemë e bukur. Nëse i tregonin për diellin - në të shfaqej menjëherë vizatimi i një dielli të shndritshëm e vezullues.



Fëmijëve u pëlqente pa masë të ulëshin e t'i tregonin Kukullës që Dëgjonte historitë e tyre, ndaj, tërë kohën mendonin për historitë e reja që do t'i rrëfenin.







Një ditë Kukulla që Dëgjon doli të takonte fëmijët që të dëgjonte ndonjë histori të re. Përreth nuk kishte asnjë fëmijë. Atëherë, nisi të këndonte këngën e saj të preferuar, që të mblidhte fëmijët:



*"Kudo që shkoj,
këdo që takoj,
Një histori të re dëgjoj."*



Befas, qielli u vrenjt. Kukulla që Dëgjon vuri veshin në tokë dhe dëgjoji një zhurmë të çuditshme; ishte një zhurmë që ajo nuk e kish dëgjuar kurrë më parë.

Ç'të ishte vallë?

Ishte një zhurmë ulëritëse, shungulluese, që sa vinte dhe shtohetj. Kukulla që Dëgjon ndjehej e frikësuar.






Ishte zhurma e një ere të fortë, që frynte gjithnjë e më shumë dhe që sa vinte e afrohej më shumë;

që vërtitej, duke marrë me vete gjithçka që i dilte përpara.

"Ik ! Largohu!" u përpoq të thërriste ajo.

Por, era nuk donte t'ia dinte për thirrjet e saj. Ajo vazhdonte të frynte e të frynte.







12 ...

Era ia grisi dhe ia flaku larg **pallton-** e **historive**. Kukulla që Dëgjon, humbi gjithçka që kishte.

Kur era pushoi, Kukulla që Dëgjon ndjehej keq, e mërzhitur dhe shumë e trishtuar.





Befas, një zog i vogël i mençur fluturoi mbi të. Ai vuri re që Kukulla që Dëgjon, që po rrinte vetëm, dhe dukej e trishtuar.

"Ciu ciu, kush je ti?" pyeti ai.

"Unë jam Kukulla që Dëgjon, mendoja se më njihje. Një erë e marrë fryu dhe më mori me vete edhe **pallton- e historive**. Tani s'më ka mbetur asgjë."

Zogu u habit pa masë.

"Eja me mua, i tha - do të të çoj në një vend të veçantë, ku ruhet një sekret, vetëm për ty."

"Një sekret? Vetëm për mua?" e pyeti Kukulla që Dëgjon e çuditur.

"Po!" i tha zogu i vogël.





"Pemët kanë një sekret, të cilin duan të ta thonë vetëm ty. Eja, të shkojmë në pyll. Do e shohësh vetë...

Edhe pse erë e madhe fryu,
Pemët, të forta qëndruan
Me rrënjët thellë në tokë shtrënguar;







Kukulla që Dëgjon pa sa të fuqishëm ishin trungjet e pemëve.

A kishin ato, vërtet, një të fshehtë për t'i treguar?

"Ju lutem, ma tregoni të fshehtën tuaj" u tha ajo. "Si e përballuat ju gjithë atë erë të marrë?

Mua, ajo më mori gjithçka, madje edhe
pallton time të historive."

Pemët e dëgjuan të heshtura. Kukulla që Dëgjon po ndjente se sa të forta dhe të mira ishin pemët.

"Edhe unë kam një të fshehtë," tha ajo më në fund. Dhe nisi t'u rrëfente atyre diçka që e shqetësonte prej kohësh dhe që nuk ia kishte treguar askujt tjetër më parë.

"Eshtë faji im.

Unë e kam fajin që fryu ajo erë e marrë. Unë duhej ta kisha ndalur."









Pemët e dinin se ç'duhej të bënin. Nuk ishte faji i saj që fry erë e fortë, kjo nuk ishte e vërtetë!

Gjethet i fshinë lotët dhe degët e mbajtën me shumë përkujdesje.

Më pas, duke qëndruar lart në pemë një zë që vinte përmes trungut nga rrënjët e thella të pemëve i pëshpëriti asaj të fshehtë të ato dinin.







"Dëgjo se ç'duam të të themi,
Gjërat e këqia ndodhin, s'ke ç'u bën.
Por, ti, Kukull që dëgjon, ti mbetesh përsëri ajo që ke
genë!
Tani, do të të pëlqente të provoje diçka të re?
Ndoshta, do të të ndihmonte të ndiheshe më mirë."

"Çfarë d-d-d-uhet të bëj?" pyeti me qetësi ajo.



"Mbyll sytë dhe buzëqesh," pëshpëritën pemët.
Kukulla që dëgjon u përpoq të vinte buzën në gaz.

Iu duk e çuditëshme të buzëqeshte me gjithë atë
trishtim që po e mbyste brenda vetes, me sytë e saj
të mbyllur!

Iu desh pak kohë, por pas një copë here, ndjeu se brenda vetes po **buzëqeshte**.

Për habinë e saj, ndjeu se po vazhdonte **të buzëqeshte** edhe kur hapi sytë!

Vështroi rreth e rrotull dhe pa gjithçka që era nuk i kishte marrë me vete.

Pema dukej e lirë;  dielli dukej i gëzuar;  qielli ishte i shndritshëm.

Dhe atëherë... kur ajo hodhi sytë poshtë, si me magji, mbi trupin e saj kishte sërish një **pallto** të re **historish**, plot e përplot me vizatime.






"Faleminderit, pemë!" tha ajo, dhe pastaj vrapoi menjëherë për të gjetur ndonjë fëmijë, të cilit t'i tregonte të fshehtën e **buzëqeshjes** së brendshme.

"Ejani," u tha ajo, "Provojeni dhe ju. Nëse jeni të trishtuar, ose kur nuk dini se ç'duhet të bëni, kujtohuni se brenda jush, ka diçka të vërtetë.

Sepse...

Askush nuk mund t'iu marrë
buzëqeshjen tuaj të brendshme!"





Gjeni buzëqeshjen tuaj të brendshme

Rrini të ulur qetësisht. Mbyllni sytë.

Dëgjoni frymëmarrjen tuaj.
Dëgjoni të gjitha zhurmat rreth jush.

Pastaj... me sytë e mbyllur... buzëqeshni.
Ndjeni se sa të lumtur do të ndjeheni kur buzëqeshni
me sytë e mbyllur.

Kukulla që dëgjon e quan këtë buzëqeshja
e saj e brendshme

Po ju, a e keni buzëqeshjen tuaj të brendshme?



Dëgjoni dhe Veproni

Fëmijët kanë të drejtë për përkujdesje dhe mbrojtje. Save the Children ka përgatitur për fëmijët materiale nëpërmjet të cilëve ata të njohin të drejtat e tyre. Këto materiale janë të dobishme edhe për punonjësit e fushës të mbrojtjes së fëmijëve në mënyrë që ata të nxisin zhvillimin e fëmijës, të përkujdesen dhe të mbrojnë ata.

1. Të dëgjosh, të mësosh dhe të veprosh

Punonjësit e Save the Children dhe punonjësit e fushës së mbrojtjes së fëmijëve, të cilët dëshirojnë të dinë më shumë lidhur me masat përkatëse për mbrojtjen e fëmijëve, do të përfitojnë nga leximi dhe përdorimi i këtij libri. Libri trajton pasojat e dhunës kundër fëmijëve, përditëson Studimin e OKB-së mbi Dhunën ndaj Fëmijëve dhe këshillon se si duhet të veprohet për promovimin e mbrojtjes së fëmijëve.

2. Të mbrojmë fëmijët!

Ky libër synon të ketë lexues/ përdorues të gjithë punonjësit që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët si mësuesit, edukatorët, punonjësit e qendrave të strehimit dhe institucioneve të ndryshme, pjesëtarët e komiteteve të mbrojtjes dhe punonjësit socialë, përfshi këtu edhe prindërit. Libri është i lehtë për t'u lexuar dhe kuptuar nga fëmijë, si edhe jep këshilla praktike se si të mbështeten ata.

3. Kukulla që dëgjon

Ky është një libër i ilustruar me përralla për fëmijët e moshës nga katër vjeç e sipër, të cilët kanë qenë objekt traumash dhe situatash të vështira në jetë. Është historia e një Kukulle që përballet me një erë të fuqishme, e cila i shkatërron jetën. Një zog i urtë e

merr dhe e shoqëron atë në një pyll, pemët e të cilët do i tregojnë asaj një të fshehtë. “Gjërat e këqia ngjasin, s’kemi ç’bëjmë, por ti mbetesh prapë ajo që ishe.” Ata e mësojnë të dëgjojë sipas një mënyre të re, e cila do t’i japë asaj forcë dhe besim në të ardhmen. Kjo përrallë mund të shoqërohet nga një kukull, e përgatitur nga fëmijët si një veprimtari gjeneruese të ardhurash.

4. Unë, ti të gjithë të mbrojtur

Ky libër u kushtohet fëmijëve të moshës shtatë vjeçare e lart. Nëpërmjet tij fëmijët kanë mundësinë të mësojnë rreth llojeve të ndryshme të dhunës, me të cilën mund të ndeshen fëmijët nëpër botë si dhe t’u japë atyre ide për mbrojtjen e vetes. Libri i nxit fëmijët të bëjnë pyetje dhe të shfaqin mendimet e tyre.

5. Unë dhe ti të barabartë

Nëpërmjet këtij libri, fëmijët, duke filluar nga ata të moshës shtatë vjeçare, mund të mësojnë rreth llojeve të diskriminimit me të cilët ata mund të ndeshen në jetën e tyre të përditshme si dhe rreth formave të ndryshme të diskriminimit me të cilat ndeshen fëmijët e tjerë në mbarë botën.

Save the Children ka mbështetur Kombet e Bashkuara në realizimin e Studimit mbi Dhunën kundër Fëmijëve (2006) dhe po ndjek në vijimësi rekomandimet e dala prej këtij studimi. Gjatë këtij procesi janë përpunuar dhe mjaft studime dhe materiale për mësim, të cilat mund të gjenden në: pjeswww.rb.se/book.shop.



Dëgjoni dhe veproni

'Kukulla që Dëgjon është pjesë e një libri me pesë pjesë, të titulluar: "Dëgjo dhe Vepro" i përgatitur nga Save the Children. Nëpërmjet këtyre librave fëmijët do të njihen me të drejtat e tyre dhe punonjësit e fushës së të drejtave të fëmijëve dhe ata të vijës së parë në mbrojtje të tyre, do të përftojnë njohurinë e nevojshme në drejtim të zhvillimit të fëmijëve, duke nxitur kujdesin dhe mbrojtjen e tyre. Librat janë të përshtatshëm si në drejtim të rasteve të emergjencës ashtu edhe të konteksteve të zhvillimit.



Save the Children